

AUTORIZIM ZYRTAR

Nr.2, datë 23.6.1999

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, si dhe të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit,

KOMISIONI I MBIKQYRJES SË SIGURIMEVE

A U T O R I Z O N

Shoqërinë Anonime “Siguracioni shqiptar” sh.a. me emrin e shkurtuar “SIGAL” me seli në Tiranë, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës me nr.Akti 20863, të kryejë sigurime për dëmet, në përputhje me lejen për ushtrim aktiviteti.

KRYETARI
Vangjel Birbo

**LEJE PËR FILLIMIN E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT
TË SIGURIMEVE DHE/OSE RISIGURIMEVE**

Shoqëria e sigurimit “SIGAL”, sh.a. e regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës me nr. Akti 20863, me seli në Tiranë në adresën Qendra e Biznesit “VEVE”, lejohet të fillojë kryerjen e operacioneve të sigurimit në grupet e sigurimit siç janë listuar më poshtë duke filluar nga data 28.6.1999.

Në mbështetje të pikës B të shtojcës së ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” grupet e sigurimit do të jenë si më poshtë:

1. Grupi nr.1 dhe nr.2 “Sigurimi i aksidenteve dhe shëndeti”
2. Grupet nr.1 (paragrafi i katërt), 3,7 dhe 10 “Sigurime motorrike”
3. Grupet nr.1 (paragrafi i katërt), 4,6,7 dhe 12 “Sigurimi i marinës dhe transportit”
4. Grupet nr.1 (paragrafi i katërt), 5,7 dhe 11 “Sigurimi i avionëve”
5. Grupet nr.8 dhe 9 “Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë”
6. Grupet nr.10,11,12 dhe 13 “Sigurimi i përgjegjësi”
7. Grupet nr.14 dhe 15 “Sigurimi i kreditit dhe i garancisë”.

Kjo LEJE PËR USHTRIM AKTIVITETI është pjesë përbërëse dhe i bashkëngjitet AUTORIZIMIT ZYRTAR Nr.2, datë 23.6.1999.

U lëshua sot në Tiranë, më datë 23.6.1999 nga KOMISIONI I MBIKQYRJES SË SIGURIMEVE dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 28 qershor 1999.

KRYETARI
Vangjel Birbo